

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUÇITRN
Nr. / Br. 57587125
Nr. i fq. / Br. st. -6-
Data: / Datum: 03.11.25
VUSHTPRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrisë
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 142/25, 30.10/2025

PROCESVERBAL

nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 21 korrik 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Adnan Lahu, Fakele Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Agron Perçuku.

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na ka ardhur një pikë shtesë për ta shtuar në rend të ditës: “Kërkesë për përkrahje financiare për shërim për Ilir Pllanën”. Iliri ka kërkuar 4500€ për një intervenim në zemër jashtë vendit, kurse shuma totale për intervenim është mbi 15,000€.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – propozoj që të futet në rend të ditës “Shfuqizimi i vendimit të kuvendit të komunës të shkolla “Ali Kelmendi”, që ju e keni quajtur këmbim i pronës, kurse ka pasur të bëjë me legalizimin e objektit banesor. Pra, ky vendim të vjen në kuvend për shfuqizim, ku publikisht e keni gënjyer qytetarin e Vushtrisë për interesa pur-oligarkike të legalizimit të një objekti. Presim që kryetari i komunës deri në seancë të kërkoj falje publike.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – kjo pikë e rendit të ditës është e përgatitur që të vjen në kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi që të shtohet në rend të ditës “Kërkesë për përkrahje financiare për shërim për Ilir Pllanën”.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.06.2025;
2. Raport për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për periudhën janar – qershor 2025;

3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024;
4. Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2024/2025;
5. Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit;
6. Draft – Rregullore për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë;
7. Draft – Plani i veprimit për transparencë komunale 2025-2028;
8. Kërkesë për përkrahje financiare për shërim për Ilir Pllanën;
9. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.06.2025.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 16.06.2025.

2. Raport për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, për periudhën janar – qershor 2025.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – kërkoj informata shtesë lidhur me lajmet që kanë qarkulluar këto ditë se llogaria bankare e komunës është bllokuar. Cilat janë arsyet e bllokimit të xhirollogarisë? Çka pritet tutje ditëve në vazhdim?

Lidhur me raportin, shifrat e shpenzimeve buxhetore që janë raportuar, shumë pak prej tyre kanë shkuar në destinim. Kjo tregon edhe për nivelin e dobët të performancës, sepse në vend që të shpenzohet buxheti aty ku është planifikuar (sidomos te investimet kapitale), një pjesë e madhe e buxhetit ka përfunduar te përmbaruesi dhe te shpenzimet e lëndëve të ndryshme që kanë përfunduar nëpër gjykata, të cilat komuna i ka humbur si raste.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – te shërbimet rezidenciale, paskan qenë të planifikuar 16,000€ dhe të gjitha kanë mbetur të pashfrytëzuara. A mund të na tregoni se pse kanë mbetur të pashfrytëzuara? Duke e ditur që aty kanë nevojë shumë për një veturë, të cilët nuk kanë kurrfarë transporti.

Abit Abiti, nga drejtoria për Buxhet dhe Financa – deklaroi se xhirollogaria e komunës është e bllokuar që nga e premtja e kaluar, kjo për arsye të vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me Kontratën Kolektive e që gjatë vitit 2025 janë marrë 1 milion e 723 mijë euro. Po ashtu, ka ardhur edhe një listë prej 900 mijë euro për t'u ekzekutuar lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me kontratën kolektive. Ai tha se mjetet financiare po merren edhe nga zotimet. Komuna e Vushtrrisë është në një situatë të palakmueshme, sepse po na anulohen edhe zotimet që janë bërë për kontratat dhe vendimet e ndryshme.

Ai tha se janë ndarë 15 mijë euro për një veturë, ku është grant specifik i shërbimeve rezidenciale. Por, kjo shumë nuk ka mjaftuar për blerjen e kësaj veture dhe kanë mbetur të pashfrytëzuara mjetet financiare. Në raportin e Ministrisë së Financave, e pashë që edhe këto mjete janë marrë për vendimet gjyqësore.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – përgjigjet e juaja nuk korrespondojnë me përgjigjen e kryetarit të komunës, i cili për mbylljen e llogarisë bankare ka deklaruar se bëhet fjalë për gabim teknik. Këtu po shihet një realitet tjetër, një çështje zyrtare të bllokimit të llogarisë bankare për shkak të problemeve dhe disbalancit financiar që ekziston në komunë dhe obligimeve që e ka fut kryetari i komunës dhe po e rrezikon stabilitetin fiskal. Përveç kësaj, nëse komuna do të ishte efikase dhe t'i kryente projektet me kohë, pagesat ishin kryer me kohë, kurse as kontrata kolektive, as thesari e përmbaruesi nuk do të mund ta dëmtonin komunën aq shumë, sepse nuk do të kishin pasur ku t'i marrin mjetet financiare. Por,

projektet janë zvarritur dhe nuk kanë përfunduar me kohë, buxheti po merret edhe nga kategoritë e ndjeshme.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrisë për vitin 2024.

Sylejman Mcholli, anëtar i KPF-së – kemi raport të kualifikuar, që është dëshmi e qartë e keqmenaxhimit dhe shkeljeve të shumta gjatë menaxhimit të pasqyrave financiare të vitit 2024. Është viti i dytë me radhë që komuna e Vushtrisë ka një raport të kualifikuar. Në vend që kryetari i komunës të ndërmarrë masa që të përmirësohen keqklasifikimet, shkeljet, mangësitë që janë evidentuar në raportin e vitit 2023 që të mos përsëriten, shumica e tyre janë evidentuar edhe në vitin 2024. Kemi shumë çështje që do t'i diskutojmë edhe në seancën e kuvendit, të cilat nuk duan koment për mënyrën skandaloze që janë gjetur shkelje në këtë raport e deri të favorizimet në tendere në prokurim publik, siç është psh. "përdorimi i markave tregtare në rastin e QMF 1", kur është blerë kalaja në vlerë prej 62 mijë euro dhe është cekur emri i prodhuesit. Kjo është shkelje flagrante e ligjit të prokurimit publik, favorizim i hapur i operatorit ekonomik që e ka fituar tenderin. Prandaj, mirë do të ishte që këto çështje t'i hetojë prokuroria, sidomos personat që kanë qenë të përfshirë në tendere dhe që i kanë përgatitur specifikat.

Po ashtu, edhe shkeljet tjera, asfaltimi, mospagimi i borxheve nga shfrytëzuesit e pronës komunale, që ka qenë rekomandim edhe nga viti i kaluar. Janë mijëra euro buxhet që po dëmtohet komuna dhe kemi një xhirollogari të komunës të bllokuar. E në ndërkohë, shfrytëzuesit e pronave komunale dhe atyre të qirasë nuk po i kryejnë obligimet e tyre sipas kontratës. Në këtë rast, në qoftë se zyrtarët kompetent dhe kryetari i komunës nuk kanë ushtruar procedura tjera administrative, që parashihen, në rast se shfrytëzuesit e pronave nuk i kryejnë obligimet sipas kontratës, atëherë kjo flet qartë se ka një bashkëpunim reciprok në këtë shkelje në mes të qeverisjes dhe shfrytëzuesve të pronave. Kryetari i komunës, si mbrojtës i interesave të komunës, mund ta zbatojë ligjin dhe t'i dërgojë në gjykatë shfrytëzuesit e pronave komunale për mospagesën e borxheve, në mënyrë që t'i kryejnë obligimet ndaj komunës. Gjë që kjo nuk ka ndodhur. Është viti i dytë me radhë që komuna dëmtohet në këtë aspekt dhe nuk janë shifra të vogla të borxheve që po lejohen që të parashkruhen, ku po i bëhen dëme të mëdha ekonomike komunës.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se prej 27 rekomandime që i ka dhënë auditori për t'u përmirësuar, 11 prej tyre nuk kanë gjetur zbatim dhe nuk ka filluar përmirësimi i tyre, me përjashtim, vetëm njëra prej tyre ka filluar pjesërisht. Te pika 19, pasi ka përfunduar operatori kontratën, i është vazhduar edhe për një vit, pa pasur garancion as paraprakisht e as vitin tjetër që i është vazhduar kontrata. Nuk është në rregull që dy vite radhazi të vjen raporti i kualifikuar për një komunë të vogël dhe me një buxhet që është shfrytëzuar komplet në mënyrë të gabuar.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2024/2025.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se ka marrë shumë shqetësime nga qytetarët dhe nga bujqit se në rrugën nga ura e Silnicës në drejtim të “Llamkosit”, në anën e djathtë, ka një pllakë masive të betonit në tokë punuesc. Kërkoj informatë se a ka leje ndërtimi ky objekt që ka filluar? A ka pasur inspektime nga Drejtoria për Inspektime? Nëse ka pasur inspektime, a janë ndërmarrë masa? Për çfarë qëllimi po ndërtohet ai objekt? Kërkoj përgjigje me shkrim nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe nga Drejtoria për Inspektime lidhur me këtë çështje se çka është ndërmarrë.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – përveç rrugës që u cek, edhe në rrugën “Drenica” në drejtim të fshatit Bukosh nuk ka pasur ndërtime, por janë bërë ndërtime në tokë bujqësore. Ndërtimet kanë filluar në mandatin e kaluar. Prandaj, ish dashur të analizohet në tërësi ajo pjesë dhe të ipen përgjigje për të gjitha.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – po më shqetëson fakti që po mundohesh me largu temën prej një dëmi të madh që po i bëhet komunës në zemrën e tokës së bujqësisë. Çdo ndërtim që ka ndodhur në çfarëdo mandati, nuk i amnistoj. Shtëpitë që i përmende kryesuese janë ndërtuar edhe para mandatit të kaluar e disa edhe në mandatin e kaluar.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – thashë që përveç asaj kah “Llamkosi”, le të analizohet edhe kjo pjesë në drejtim të fshatit Bukosh.

Adnan Lahu, anëtar i KPF-së – sa herë që Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit na sjell informatë në kuvend, këto dokumente janë qesharake. Kurrë nuk po arrijnë që t’i shkruajnë dy faqe dhe po na e fyejnë inteligjencën. Kërkoj që për kuvend ta kemi një informatë më të detajuar.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që përgatitet një informatë më e detajuar dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Draft – Rregullore për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – deklaroi se edhe në nivel qendror edhe lokal, shumë çështje kemi provuar t’i rregullojmë përmes rregulloreve, strategjive dhe akteve të ndryshme, të cilat në fund kanë përfunduar në sirtar të pluhurosura dhe të pazbatuara. Po ndalem te kapitulli II, neni 4 “Transparenca në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve”. E kemi nisur mandatin me kërkesa, që për hir të transparencës dhe kryerjes së punëve në mënyrë efikase të secilit prej nesh, të përmirësohen kushtet në sallën e kuvendit, gjë që nuk ka ndodhur. Kemi kërkuar që të përmirësohet zërimi dhe sistemi për votim elektronik në sallën e kuvendit, as kjo nuk ka ndodhur. Ne mund të miratojmë me dhjetëra rregullore, por që në praktikë nuk po zbatohen. Është shqetësues që asnjë cent gjatë këtij mandati nuk është futur në sallën e kuvendit të komunës. Ne e përkrahim këtë rregullore që të bëhet diçka më mirë, por mjetet që kanë qenë të planifikuara në buxhet për këtë sallë,

nuk janë shfrytëzuar për qëllimin e saj, por janë dedikuar diku tjetër. Jemi në kohën e teknologjisë, kurse transmetimet e mbledhjeve duhet të jenë shumë më kualitative, duke përfshirë edhe rrjetet sociale, por pse jo të ketë edhe kontratë me ndonjë portal lokal për transmetim direkt të mbledhjeve të kuvendit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Draft – Plani i veprimit për transparencë komunale 2025-2028.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Kërkesë për përkrahje financiare për shërim për Ilir Pllanën.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – në bazë të bisedës me Ilirin, në bazë të shumës që e ka cekur, po propozoj që t'i ndahen 4500€.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – pyeti se a ka mjete të mjaftueshme financiare në kategorinë e subvencioneve dhe se a do të ekzekutohet vendimi menjëherë apo do të mbetet ekzekutimi në vitin 2026?

Abit Abiti, nga drejtoria për Buxhet dhe Financa – kuvendi i komunës kur po merr shumë vendime, të cilat po mbesin të pazbatuara, në mungesë të mjeteve financiare. Për momentin e kemi sistemin të bllokuar dhe nuk e dimë se sa ka mjete financiare. Po ashtu, nuk e dimë se sa mjete do na i merr Ministria e Financave dhe nga cilat kategori, sepse 377,000€ na i ka marrë ministria nga kategoria e subvencioneve dhe kjo në masë të madhe e ka destabilizuar kategorinë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

9. Pyetje dhe përgjigje.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – kërkoi përgjigje lidhur me këto pyetje:

- Komuna ka arritur marrëveshja me organizatën CIPOF për funksionalizimin e dy kopshteve të reja për fëmijët në Stanoc të Epërm dhe Shtitaricë. Fatkeqësisht i është marrë hapësira qendrës së kulturës në Shtitaricë. Kurse, në Stanoc të Epërm bëhet fjalë për ish-objektin e shkollës, ku në të ardhmen do të ketë probleme, pasi që është pronë e AKP-së.

Me çfarë procedurash janë dhënë në shfrytëzim këto dy objekte? Me çfarë baze ligjore? A do ta financojë komuna, OJQ-në? Kush do ta bëjë subvencionimin e mirëmbajtjes së çerdheve? A është bërë ndonjë analizë se si do të funksionojë?

- Në rrugën “Ismail Qemali” ku ka qenë “Fibello”, kuvendi ka vendos që ta bëjë këmbimin e pronës. Kryetari e ka arsyetuar dhe ka thënë se do të bëhet zgjerimi i rrugës nga udhëkryqi “Te Selacët” dhe do të bëhet me katër shirita. Te “Fibello”, a

do të bëhet zgjerimi i rrugës? Çka do të bëhet me atë pjesë? (ku është e njëjta gjendje si te stacioni i ri, ku është bërë këmbimi i pronës për ta zgjeruar rrugën).

- Sa ka subvencione në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale? A do të ketë thirrje publike për t'i subvencionuar shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së?

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – A ka hyrë në fuqi vendimi të shkollës “Ali Kelmendi”? A ka pasur veprime të legalizimit të objektit në këtë periudhë, derisa ai vendim ka qenë i miratuar?

Propozoj që bashkë me vendimin për shfuqizim, të na vjen edhe informata se a ka pasur efekte juridike dhe praktike të atij vendimi në çështjen e legalizimit të objektit për këtë periudhë që po flasim.

Bastri Duraku, udhëheqës i sekretarisë – lidhur me vendimin që po i referohet anëtari i KPF-së, MAPL-ja ka konstatuar se nuk janë respektuar afatet e dërgimit të materialeve (7 ditë). Një gjetje tjetër e MAPL-së është se, anëtari i qeverisë komunale nuk ka pasur të drejtë të propozoj pikë për t'u futur në rend të ditës. Këto vendime janë pa efekt juridik nga koha që janë miratuar. Andaj, këto vendime do të vijnë në seancën e ardhshme të kuvendit (31.07.2025) për rishqyrtim dhe harmonizim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Bujar Klinaku

Procesmbajtës



Melihate Basholli - Latifi

Kryesuese e KK-së dhe KPF- së